

Dr. Kasem BIÇOKU

29 NËNTORI NUK ËSHTË DATË E ÇLIRIMIT TË SHKODRËS DHE AS FESTË KOMBËTARE E SHQIPËRISË

Qysh më 29 Nëntor 1944, kur Radio Tirana, që një ditë më parë kishte rifilluar transmetimet shumë të kufizuara në kohë, njoftoi se ishte çliruar Shqipëria, intelektual i Prengë Gruda, që punonte si arsimtar në Grudë, ka shkruar atë ditë në ditarin e tij, që e mbante prej vitesh: “Grudë, më 29 nanduer 1944. Lajme të rrejshme. Radio Tirana po lajmron se sot u çlirua Shqipnia. Ky lajm nuk asht i vërtetë, e nuk dihet pse e ka shtye çlirimin një ditë ma vonë”.

Po kështu, me vendosjen e pluralizmit politik, shumë banorë të Shkodrës, që i kishin përjetuar ngjarjet e Luftës së Dytë Botërore, kërkuan menjëherë korrigjimin e datës së çlirimit të qytetit të tyre.

Qysh më 1991, në artikullin: “Ne që jetojmë çlirimin e Shkodrës”, (gaz. “Shkodra”, 29 nëntor 1991), Zef Luigj Mjeda rrëfeu kronologjinë e ngjarjeve të 28 Nëntorit 1944, që kishin çuar në Çlirimin e Shkodrës. Korrigjimi i bërë prej tij ishte në përputhje me mbarë opinionin qytetar të Shkodrës, të cilin pas 2 vjetësh e njohu drejtpërdrejt. Krahas tyre, edhe komandantë të formacioneve partizane, që kishin marrë pjesë në çlirimin e Shkodrës, si Sadik Bektashi e Hamit Keçi dhe shumë veteranë të tjerë, e dinin mirë dhe u shprehën se Shkodra ishte çliruar më 28 Nëntor 1944.

Përballë kërkesës në rritje për saktësimin e datës së çlirimit të qytetit të Shkodrës, më 1993, me porosi të Presidentit të Republikës, z.Sali Berisha, kryesova Komisionin e Posaçëm, që u ngrit për saktësimin e datës së çlirimit të qytetit të Shkodrës.

Përfundimet e tij se Shkodra ishte çliruar më 28 nëntor 1944 iu paraqitën Kuvendit Popullor nëpërmjet një relacioni, i cili u botua në gaz. “RD”, 13 e 24 nëntor 1993, dhe në revistën “Studime historike”, nr.3-4, 1991, Tiranë 1994). Më gjerësisht për këtë çështje shkruan edhe dy anëtarë të Komisionit të Posaçëm, Mentar Belegu dhe Uran Butka (gaz. “RD”. 25-

28 nëntor 1993). Në mbështetje të përfundimeve se Shkodra ishte çliruar më 28 nëntor 1944 shkruan edhe persona të tjerë, ndër të cilët Hamit Keçi, komandant i Brigadës së 23-të që kishte marrë pjesë në çlirimin e këtij qyteti, ("RD", 11 dhjetor 1993, gaz. "Kosova", 22 dhjetor 1993 etj.).

Komisioni i posaçëm në vitin 1993 bëri vetëm saktësimin e datës së çlirimit të Shkodrës më 28 nëntor 1944 dhe nuk u mor me çështjen pse 29 Nëntori ishte caktuar si data e çlirimit të atij qyteti, pyetje që po i përgjigjemi tani, sepse ende ka nostalgjikë të indoktrinuar dhe kontigjentë enveristësh të përbetuar, që kërkojnë të ridhunohet historia kombëtare dhe të rifillojnë kremtimin e 29 Nëntorit si datë të çlirimit të Shkodrës dhe të të gjithë Shqipërisë. I tillë është edhe juristi Xhelal Gjeçovi, i përforcuar në këtë profesion edhe me titullin e vjetër pedagogjik të docentit. Në vend që të merret me profesionin e tij të nderuar dhe shumë të lakmuar të juristit, Xh.Gjeçovit i është mbushur mendja se e ka më lehtë (dhe për këtë e kanë inkurajuar vazhdimisht edhe eprorët e tij, që sapo e kanë emëruar zëvendës drejtor të Institutit të Historisë) të merret me studimin e historisë. Por historia nuk studiohet e shkruhet ashtu siç dëshiron dhe e shkarravit juristi docent Xh.Gjeçovi, me frazeologji boshe, të mbyshur me fyerje e denigrime ndaj punës së të tjerëve ("Zëri i popullit", 21 tetor 1997), por nëpërmjet fakteve historike, që sigurohen me përgatitje profesionale e me punë të mundimshme për njohjen e shqyrtimin analitik të burimeve historike.

* * *

Datat përkujtimore, veçanërisht ato që kremtohen si festa zyrtare, nuk mund të caktohen rastësisht, por u përkasin episodeve më të rëndësishme e më përfaqësuese të ngjarjeve madhore të historisë, që mund të jenë fillimi, kulmimi e finalizimi i tyre si procese historike, si marrëveshje politike etj. Datat përkujtimore, duke mbartur vlera të dyfishta të ngjarjeve madhore historike dhe të episodeve më të qenësishme të tyre, shndërrohen në simbole të historisë që përcjellin emocione dhe mesazhe mbarëkombëtare e më gjerë kur ata kanë pasur përmasa të tilla. Për këtë mjafton të kujtohen disa episodë të Luftës së Dytë Botërore.

Si datë përkujtimore e mbarimit të Lutës së Dytë Botërore dhe e fitores së Koalicionit të Madh Antifashist në Evropë, pjesë e të cilit ka qenë edhe Lufta Çlirimtare Antifashiste e popullit shqiptar, nuk u caktua 2 maji i vitit 1945, kur trupat sovjetike morën Berlinin, as datat 7 e 8 maj, kur komanda e ushtrisë gjermane nënshkroi aktin e kapitullimit, përkatësisht me përfaqësu-

esit e ushtrisë anglo-amerikane dhe të asaj sovjetike, por 9 Maji i vitit 1945, dita kur garnizoni gjerman i Pragës u detyrua me luftë të dorëzohej. Pas kësaj ngjarjeje ushtritë gjermane i ndërpreu përfundimisht veprimet luftarake edhe pse do të vazhdonin të qëndronin për disa kohë në Çekinë Perëndimore dhe në rajone të tjera. 9 Maji i vitit 1945 kremtohet kudo nëpër Evropë si ditë e fitores së përbashkët të Koalicionit të Madh Antifashist. Edhe në Shqipëri, qysh në mbrëmjen e asaj dite, Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, vendosi që 9 Maji të shpallet festë kombëtare dhe si e tillë u kremtua për shumë vite në vendin tonë.

Pas pak, krahas 9 Majit, u vendos, jo pa kundërshtime, që të përkujtohet si festë kombëtare edhe dita e Çlirimit të Shqipërisë.

Meqenëse në Shqipëri fitorja e forcave antifashiste, në Luftën e Dytë Botërore kremtohej si festë zyrtare. nëpërmjet dy episodeve e datave të ndryshme, pas disa vitesh, u vendos që njëra prej tyre të hiqej. Është e kuptueshme se në kuadrin e politizimit dhe të shtrembërimit gjithnjë e më të thellë që po i bëhej historisë në përshtatje me qëndrimet delirante të Enver Hoxhës, u hoq 9 Maji.

Në vendet komuniste evropiane, krahas 9 Majit, qysh në fillim u përkujtuan episodet kryesore nga periudha e Luftës II Botërore që kishin të bënin me rrugën që ndoqën forcat komuniste për të ardhur në pushtet. Në Jugosllavi si festë e madhe kombëtare, siç cilësohej edhe në pritjen e dhënë me rastin e kremtimit të saj nga Legata Jugosllave në Tiranë më 1945, (gaz. "Bashkimi", 30 nëntor 1945), kremtohej 29 Nëntori i vitit 1943, dita kur në Jajcë të Bosnjes u bë Mbledhja II e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë (AVNOJ), ku u hodhën themelet organizative të shtetit komunist. Në Jajcë Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar i Jugosllavisë mori atributet e një organi ligjvënës, u krijua Komiteti Antifashist Nacionalçlirimtar i Jugosllavisë si organ ekzekutiv me atributet e një qeverie, u vendos që Jugosllavia e pasluftës të ishte një shtet federativ i përbërë nga gjashtë republika sllave. Data 29 nëntor 1943 si ngjarje madhore shënohej kudo, në stemën e republikës, në kartmonedhat e emetuara në Jugosllavinë komuniste etj. Në përkujtimet e sanksionimit të Mbledhjes II të AVNOJ-it e të vendimeve të saj, dy vjet më pas, më 29 nëntor 1945, u shpall Republika Popullore Federative e Jugosllavisë.

Me vendimet e 29 nëntorit 1943, të Mbledhjes III të AVNOJ-it, çështja Kombëtare Shqiptare u dëmtua rëndë në shumë drejtime e me veprime afatgjata. Ato jo vetëm zhvleftësuan Rezolutën e Konferencës Krahinore Nacionalçlirimtare për Kosovën, të mbajtur në Bujan në fund të

shqiptare me Shqipërinë, por vendimi për krijimin e Jugosllavisë Federative i përbërë nga gjashtë republika sllave ishte thellësisht antishqiptar. Nëpërmjet këtij vendimi ligjësohej vendosja e pushtetit sllav në viset etnike shqiptare, që në kushtet e pushtimit fashist iu bashkuan Shqipërisë më 1941, banorët e të cilëve realisht ndjeheshin më pak të robëruar se sa kishin qenë në Mbretërinë Jugosllave. Përveç kësaj, duke projektuar ndarjen e viseve etnike shqiptare në tri republika sllave, (Serbi, Maqedoni e Mali i Zi), vendimet e 29 nëntorit 1943 të Mbledhjes II të AVNOJ-it do të dobësonin shumë peshën dhe rolin e shqiptarëve në Jugosllavi si popullsia e tretë më e madhe në atë shtet, do të dëmtonin rëndë lidhjet shekullore dhe unitetin historik të tyre, rrjedhojat negative të të cilave ndjehen te shqiptarët edhe më shumë sot pas shpërbërjes së Jugosllavisë.

Prandaj për shqiptarët të cilët jetojnë në Kosovë, Serbi, Maqedoni e në Mal të Zi, 29 nëntori është ditë dhe simbol fatkeqësie për dramën e thellë kombëtare të tyre dhe si e tillë, si datë gjymtimi, si datë e një plage të hapur në trupin e kombit ajo duhet konsideruar nga të gjithë bashkëkombasit tanë kudo që ata jetojnë.

* * *

9 Maji i vitit 1945 ka qenë e para “festë kombëtare”, që filloi të kremtohej në Shqipëri në përkujtim të fitoreve të forcave të Koalicionit të Madh Antifashist gjatë Luftës së Dytë Botërore, pjesë e të cilit ka qenë edhe lufta e shqiptarëve. Dy javë më pas, më 22 maj 1945, Kryesia e Këshillit ANÇ, sipas shembullit të simotrës jugosllave, vendosi që të kremtohej si “festë zyrtare”, 16 Shtatori, (Konferenca e Pezëz), 10 Korriku, (formimi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë NÇ) dhe 24 Maji (Kongresi i Përmetit).

Vendimet e Kongresit të Përmetit, nën dirigjimin e emisarëve jugosllavë, ishin një kopjim i vendimeve të 29 nëntorit 1943 të Mbledhjes II të AVNOJ-it, ashtu siç kishte bërë vazhdimisht E.Hoxha, duke imituar gjithçka jugosllave, deri edhe në huazimin e emërtimeve për organeve politike, ushtarake etj, që u krijuan në Shqipëri gjatë viteve të luftës e më pas. Megjithë këto, jo rastësisht, 24 maji (Kongresi i Përmetit) si ditë feste nuk do të merrte ato ngarkesa maksimale të simotrës jugosllave, të 29 nëntorit (Mbledhjes II të AVNOJ-it), sepse qysh në Kongresin e Përmetit, E.Hoxha u shpreh: “Do të punojmë për realizimin e një Konfederate Ballkanike” nën drejtimin e Titos, që do të sillte humbjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe kthimin e saj në Republikë të Shtatë të Jugosllavisë. Këtë politikë të E.Hoxhës e tregojnë mirë dokumentet e vëllimit “Marrëdhëniet

shqiptaro-jugosllave 1945-1948”, që dolën në dritë për herë të parë në vitin e kaluar, si botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit.

Në kuadrin e përshpejtimit të procesit të bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë, E.Hoxha kërkoi bashkimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë me atë të Jugosllavisë dhe kishte deklaruar se për PKSHP “Sekretar i përgjithshëm nuk do të jem unë, por Mareshali Tito”. Po kështu edhe gjatë viteve të Luftës përfaqësuesi jugosllav, Miladin Popoviq, kishte qenë kryetari real i PKSHP-së. Prandaj PKSHP nuk u bë anëtare e Byrosë Informative të PK-së së Evropës, sepse ajo përfaqësohej në të nëpërmjet PK-së së Jugosllavisë.

Si një hallkë tjetër në zinxhirin e lidhjeve skllavëruese të Shqipërisë me Jugosllavinë u sajua edhe një “ditë feste e përbashkët”, siç e cilësonte 29 Nëntorit E.Hoxha, në telegramin që i dërgoi Titos në vitin 1946, (gaz, “Bashkimi” 29 nëntor 1946).

Caktimi i 29 Nëntorit si “Festë Kombëtare” për të përkujtuar Çlirimin e Shqipërisë, u bë në mbledhjen e Kryesisë së Këshillit ANÇ të 9 nëntorit 1945, e cila u mor kryesisht me caktimin e “kremteve kombëtare, civile dhe fetare”. Kur shqyrton me kujdes procesverbalin e kësaj mbledhjeje për caktimin e 29 Nëntorit si e “kremte kombëtare” del prapaska e maskuar mjeshtërisht dhe që të kujton letrën e E.Hoxhës drejtuar më 15 shtator 1944 Gjin Markut, në të cilën e porositte se si të maskoheshin marrëdhëniet e tij me majorin jugosllav Voja: “Ki kujdes që për sy e për faqe të mos duket dashuria e veçantë që kemi për këtë shok, pastaj në intimitet bëni si të doni “(Arkivi i Shtetit, KQPKSH, Fondi 14, Lista 1, njësia 81), apo kur i shkruante Miladin Popoviqit që të merrej me hetimin e veprimtarisë së Mustafa Gjinishit, (A Sh, Fondi KQPKSH, v.1943, D 23/1).

Data e 29 nëntorit, si ditë feste e çlirimit nuk u miratua nga të gjithë anëtarët e Kryesisë së Këshillit ANÇ dhe kjo u kërkua me insistimin e Ramadan Çitakut (i cili do të tregonte në atë mbledhje edhe kohën kur gjermanët ishin larguar nga Shqipëria, edhe pse ai nuk kishte qenë pjesëmarrës në luftën për çlirimin e Shkodrës) i cili atë ditë, më 28 nëntor 1944, sapo kishte ardhur në Tiranë prej Beratit si anëtar i KNÇ i ngarkuar me punët financiare dhe si anëtar i Komitetit ANÇ (i shndërruar në Berat në qeveri të përkohshme). Ramadan Çitaku ka qenë një ndër përkrahësit më të flakët të vijës politike të E.Hoxhës për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë, pra federalist titist i orëve të para. Ai ka qenë ambasadori i parë i Shqipërisë në Beograd dhe nuk ka dyshim se ishte urdhëruar nga Tito që 29 nëntori të shpallej edhe në Shqipëri si datë feste kombëtare. Këtë kërkesë Tito ia kishte drejtuar më parë Enver Hoxhës qysh me telegramin e

28 nëntorit 1944, ku urdhëronte: “Tani edhe festat do t’i kemi të përbashkëta” (gaz. “RD”, 25 nëntor 1993).

Le t’i kthehemi procesverbalit të mbledhjes së 9 nëntorit 1945 të Kryesisë së Këshillit ANÇ, që ka filluar në orën 15.00. Procesverbali që disponohet nuk është në dorëshkrim, por është një kopje e daktilografuar dhe mjaft e përmbledhur, aq sa ka edhe ndonjë rast ku janë shënuar emrat e dy diskutuesve njëri pas tjetrit dhe në vijim diskutimet e tyre sikur të ishte një i vetëm.

Në krye të procesverbalit janë shënuar emrat e anëtarëve të Kryesisë, të cilët ishin të pranishëm në atë mbledhje, si dhe të atyre që mungonin. Mbledhjen e ka hapur kryetari Omer Nishani dhe kërkoi që të diskutohej për “projektligjin për të Kremtet Zyrtare”. Diskutimet nisën me fjalën e Tuk Jakovës, i cili, si përfaqësues i sindikatave, kërkoi të shtohet si ditë feste 1 maji, sepse ishte harruar në Projektligjin e paraqitur. Pasi u votua për të unanimisht, e mori fjalën Baba Mustafa Xhani, i cili kërkoi që në Projektligj të përfshihej edhe dita e Nevruzit. Me këtë rast ndërhyri Gjergj Kokoshi dhe kërkoi të dinte kriteret që janë përdorur për caktimin e kremteve fetare, të cilin e sqaroi Manol Konomi. Pas këtyre e mori fjalën Bedri Spahiu, ish anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ, i cili kërkoi që në Projektligj emërtimi i festës së 28 Nëntorit të zgjerohet dhe të përfshinte edhe ditën e Çlirimit të Shqipërisë. Ja si është në procesverbal:

“Sh.Bedri Spahiu: Dita e 28 Nëntorit koencidoj me çlirimin e Shqipërisë, d.m.th me rënien e Shkodrës, prandaj propozoi që emërtimi i festës së 28 Nëntorit të bëhet: **Dita e Indipendencës dhe e Çlirimit të Shqipërisë** – (nuk përkrahet).

Sh.Bedri Spahiu insiston të vihet në votë.

Sh.kryetar e vë në votim dhe nuk pranohet (votojnë për vetëm pesë)”.

Pas këtij votimi e mori fjalën Baba Mustafa Xhani për çështje festash fetare si dhe Gjergj Kokoshi e Myslym Peza. Pas votimit për festat fetare bëhet pesë minuta pushim, kur mbledhja thuhet se kishte filluar për të vazhduar pastaj gjatë kohë dhe pandërprerje deri në fund, siç e tregon qartë procesverbali i saj.

Këto pesë minuta pushimi, me sa nënkuptohet, iu deshën E.Hoxhës si regjisor federalist titist, të kurdiste papagallin federalist, R.Çitakun, të argumentonte pse 29 Nëntori duhej caktuar si ditë feste për të përkujtuar çlirimin e Shqipërisë. Rreth saj u diskutua më shumë se për të gjitha festat e tjera të marra së bashku, sepse diskutuesit nuk qenë të një mendjeje.

Le t'i kthehemi procesverbalit. Në fjalën që mori menjëherë pas pushimit, R.Çitaku tha se në Projektligj "është harruar të vihet dita e çlirimit të Shqipërisë... Dita e 28 Nëntorit 1912 është e drejtë të festohet, por edhe kjo e Luftës së Dytë, e Luftës së Madhe duhet të shtohet (përkrahet). Vetëm është çështja e datës. Me sa di unë, pas mesnatës së 28 nëntorit 1944, armiku që zhdukur nga e gjithë Shqipëria d.m.th. Dita 29 nëntor u gdhi duke qenë Shqipëria e çliruar. Prandaj propozoj që dita e 29 nëntorit të shtohet në ditën e festave kombëtare. Ne kemi vënë ditën e mbarimit të luftës së përbotshme, e të mos vemë ditën e çlirimit të Shqipërisë më duket se do të ishte gabim".

Sh. Hasan Pulo. Nuk kam kundërshtim për sa tha baca. Po desha të di se a kanë gjithë ata shtete që kanë luftuar dhe kanë hequr të zezat më shumë se prej nesh?

Sh. Ramadan Çitaku. Në Jugosllavi, ditën e çlirimit të Beligradit e mbajnë si festë të përgjithshme. Edhe ne mos e kanë gjetkë ne mund ta bëjmë, dhe ne kemi luftuar më shumë nga të tjerët

Sh. Hasan Pulo. Gjithë shtetet një ditë kanë festë të indipendencës së tyre.

Sh. Ramadan Çitaku. Pamë në bullgari që megjithëse nuk kanë bërë luftë dhe ditën e çlirimit e kanë bërë festë".

Pas diskutimeve të mësipërme vijuan Koço Tashko, Qirjako Harito, Gjergj Kokoshi, Spiro Moisiu e Myslym Peza, të cilët, me përjashtim të Gjergj Kokoshit, përkrahën kërkesën e R.Çitakut. Gjergj Kokoshi kundërshtoi futjen në Projektligj të 29 nëntorit si ditë feste dhe kërkoi të jetë vetëm dita e 9 majit mbasi lufta ishte e përbashkët dhe dita e Çlirimit të jetë e përbashkët".

Kërkesën e Gj.Kokoshit e kundërshtuan Spiro Moisiu e Myslym Peza dhe pas tyre e rimori fjalën R.Çitaku, i cili insistoi që 29 Nëntori të pranohet si festë kombëtare. Në mbështetje të insistimit të tij diskutuan Koço Tashko, Tuk Jakova e Haxhi Lleshi. Mendimin e K.Tashkos se "Shqipëria u çlirua në bazë të luftës tonë, kurse më 1912 fitoi indipendencën në bazë të marëveshjeve politike" e kundërshtoi menjëherë Gj.Kokoshi, i cili theksoi se "përveç rolit diplomatik janë vrarë dhe shqipëtarë për t'u fituar indipendencën e Shqipërisë".

Diskutimin për 29 Nëntorin e mbylli kryetari O.Nishani, i cili "sqaron mendimet e shprehura dhe vë në dukje se Shqipëria e kish humbur indipendencën e saj, kështu 29 Nëntori është një çlirim i dytë i Shqipërisë, të cilin e fituam me gjak.

Pasataj e vë në votë dhe pranohet me shumicë”.

Mbledhja e Kryesisë së Këshillit ANÇ vijoi pandërprerje me leximin e miratimit e 8 neneve të Projektligjit në fjalë si dhe me diskutimin e dy projektligjeve të tjera (Mbi planin e Pazarit të Vjetër dhe mbi ushtrimin e kreditit bujqësor).

Fryma e përgjithshme e diskutimeve për 29 nëntorin, me përjashtim të H.Pulos e Gj.Kokoshit, ishte për të nxjerrë ditën e çlirimit si ngjarjen më të madhe të historisë së Shqipërisë. Kjo ka qenë një nga arsyet kryesore pse insistimin e B.Spahiut, që emërtimi i festës së 28 Nëntorit si ditë e pavarësisë të zgjerohej edhe me atë të çlirimit të Shqipërisë, e përkrahën vetëm pesë anëtarë të Kryesisë së Këshillit ANÇ. Asnjë nga anëtarët e këtij Këshilli nuk e kundërshtoi mendimin e Bedri Spahiut se Shkodra ishte çliruar më 28 nëntor. Këtë fakt e pranoi tërthorazi edhe R.Çitaku, kur tregoi se “me sa di unë pas mesnatës së 28 nëntorit 1944, armiku që zhdukur nga e gjithë Shqipëria, d.m.th dita e 29 nëntorit u gdhi duke qenë Shqipëria e Çliruar”.

Me këto fjalë R.Çitaku nuk e ka kundërshtuar aspak mendimin e Bedri Spahiut se Shkodra ishte çliruar më 28 nëntor 1944. Përkundrazi ai e ka pranuar këtë fakt kur deklaroi se ushtritë gjermane ishin larguar pas mesnate së 28 nëntorit nga e gjithë Shqipëria, rrjedhimisht edhe nga rajoni veriperëndimor i saj që shtrihet nga Shkodra deri në kufirin me Malin e Zi në drejtim të Hanit të Hotit. Ky rajon përshkohej nga një rrugë 35 km e gjatë, që ishte e paasfaltur dhe e pashtuar mirë. Që të arrinin kalimin e kufirit në kohën e përmendur nga R.Çitaku, ushtarët gjermanë, shumë prej të cilëve ishin këmbësorë, detyrimisht kanë qenë larguar shumë orë më parë nga qyteti i Shkodrës dhe rrethinat e tij. Ende sot, ata që i kanë përjetuar ngjarjet, kujtojnë se në mbasditën e 28 nëntorit, kur në rrethinat verilindore të Shkodrës trupat gjermane ishin grumbulluar për të vazhduar marshimin goditën me artileri forcat partizane në zonën e Urës së Mesit, duke i larguar ata dhe vetë marshuan të pashqetësuar nëpër rrugën e Hanit të Hotit. Pas aksionit të artilerisë gjermane nuk ka pasur më asnjë episod luftarak me pushtuesit dhe armët heshtën, fakt që e ka pranuar edhe R.Çitaku kur deklaronte se “29 Nëntori u gdhi, duke qenë Shqipëria e çliruar”.

Kur shqyrtohet procesverbali i mbledhjes së Kryesisë së Këshillit ANÇ, të 9 nëntorit 1945 konstatohet se nuk ka qenë e rastit që anëtarët e tij i miratuan festat e tjera unanimisht e pa diskutime të shumta, kurse për 29 nëntorin diskutuan 10 anëtarë dhe ajo u miratua me shumicë votash, çka dëshmon se që në fillim ka pasur rezerva e kundërshtime për të. Diskutuesit, duke përfshirë edhe R.Çitakun, nuk kanë qenë të pranishëm në ngjarjet për

çlirimin e Shkodrës dhe as të lidhur me to, prandaj ky, sipas procesverbalit, kur e ka marrë fjalën për herë të fundit ka “treguar edhe një herë historinë e çlirimit të Shkodrës” si e dinte ai (“me sa di unë”), siç u shpreh që në fillim kur mori fjalën për herë të parë. Gjithnjë sipas procesverbalit, për 29 nëntorin nuk diskutuan Bedri Spahiu, Dali Ndreu, Enver Hoxha, Baba Mustafa Xhani, Sami Baholli, Gogo Nushi, Islam Radovicka, Kristo Themelko, Manol Konomi, Medar Shtylla, Nako Spiro, Ollga Plumbi dhe Spiro Koleka. Nga këta, tre të parët kanë qenë më mirë të informuar nga të gjithë anëtarët e tjerë të Kryesisë së Këshillit ANÇ për datën e kohën e saktë të Çlirimit të Shkodrës. B.Spahiu, ish anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ dhe si i mirinformuar, insistoi për 28 nëntorin si datë e çlirimit të Shkodrës dhe asnjë nuk e kundërshtoi se nuk ishte e vërtetë, duke përfshirë edhe R.Çitakun që propozoi 29 nëntorin, që sipas tij “u gdhi duke qenë Shqipëria e çliruar”. E Hoxha, si komandant i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ, i dinte mirë ngjarjet por heshti, sepse ishte regjisori i inskenimit të 29 nëntorit si ditë feste. Kurse Dali Ndreu, ish-komandant i Korpusit I, që kishte marrë pjesë në çlirimin e Shkodrës, nuk foli gjatë debatit për 29 nëntorin, sepse ai duhet të ketë qenë një nga pesë anëtarët e Kryesisë së Këshillit ANÇ që kanë përkrahur propozimin e B.Spahiut për 28 nëntorin si ditë e çlirimit të Shkodrës dhe të gjithë Shqipërisë. Edhe tre të tjerët, që kanë votuar për 28 nëntorin, kanë qenë nga anëtarët e Kryesisë që heshtën gjatë diskutimit për 29 nëntorin, po ashtu siç bëri edhe B.Spahiu, i cili pas votimit për 28 nëntorin nuk diskutoi më në mbledhje.

Nga shqyrtimi i procesverbalit të mbledhjes së 9 nëntorit 1945 të Kryesisë së Këshillit ANÇ del një fakt i pakundërshtueshëm që federalistit titist, ish-ambasadori i parë i Shqipërisë në Beograd, R.Çitaku, ishte parapërgatitur mirë për ta bërë, sipas porosisë së Titos, 29 nëntorin datë feste përkujtimore për çlirimin e Shqipërisë, sepse ai jo vetëm ishte strumbullari i diskutimit, por edhe nga shembujt analogë që përdori, duke iu referuar dy vendeve ballkanike (Jugosllavisë e Bullgarisë), ishin në vijim të platformës së maskuar për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë, të cilën E.Hoxha e kishte treguar hapur në Kongresin e Përmetit, duke e prezentuar si Konfederatë Ballkanike, që do të kryesohej nga Tito.

Pyetjes së nënkryetarit H.Pulo, nëse, përveç 9 majit, ditën e çlirimit e kishin festë vendet e tjera, R.Çitaku iu përgjegi: “Në Jugosllavi ditën e çlirimit të Beligradit e mbajnë si festë të përgjithshme”. H.Pulo replikoi “gjithë shtetet nga një ditë kanë festë të çlirimit të tyre”, kurse R.Çitaku reagoi menjëherë “pamë në Bullgari se megjithëse nuk kanë bërë luftë edhe ditën e çlirimit e kanë bërë festë”. Por jo rastësisht i mirinformuar R.Çitaku

nuk tregoi se dita e çlirimit në Bullgari përkujtohej me episodin e çlirimit të Sofjrs si kryeqytet (9 shtatori), po ashtu si në Jugosllavi me çlirimin e Beogradit (20 tetori), sepse mund t'i hapeshin petët lakrorit dhe të zbulohesh synimi i vërtetë i propozimit të tij, që do të kundërshtohesh prej shumë anëtarëve të Kryesisë së Këshillit ANÇ. Kryefederalisti titist E.Hoxha, nëpërmjet papagallit të tij R.Çitaku, për herë të parë e për qëllime të mbrapshta nuk imitoi shembuj adhures për të, ato të Titos, që të propozonte si ditë feste përkujtimore 17 Nëntorin. ditën e çlirimit të Tiranës, jo se donte të shkëputesh prej padronit Tito, por për të tregur devocionin e tij për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë.përdori edhe datën e 29 nëntorit 1944, që kishte qenë një ditë fare e zakonshme, pa asnjë episod lufte sado modest e jo më episod përfaqësues, siç e meritojnë dhe e kanë të gjitha ngjarjet e mëdha të historisë sonë kombëtare.

Jo vetëm si episode historike përkujtimore, por edhe nga përmbajtja ndryshonte thellësisht kryefesta e Shqipërisë me atë të Jugosllavisë. 29 nëntori jugosllav përkujtonte si kryefestë etapat më të rëndësishme të vendosjes së regjimit komunist në atë vend (Mbledhjen II të AVNOJ-it të vitit 1943 dhe shpalljen e Republikës Komuniste më 1945), duke kaluar në plan të dytë datën e çlirimit, 20 tetorin. Kurse në Shqipëri ngjarjet analoge u vendosën në pozicione vlerësimi të kundërta: Kongresin e Përmetit (24 maj 1944) dhe shpalljen e Republikës (11 janar 1946) E. Hoxha i kaloi në plan të dytë në krahasim me ditën e çlirimit, 29 nëntorin 1944, me qëllimin e mbrapshtë që, ashtu siç ia kishte kërkuar Tito qysh në nëntor të vitit 1944, vendi ynë të kishte me Jugosllavinë “një ditë feste të përbashkët” dhe siç ka shkruar vetë E. Hoxha, ditë feste që është simbol i antikombëtarizmit të thellë të tij për robërimin e Shqipërisë nga armiqtë e saj shekullorë.

Prandaj 29 nëntorin 1944, këtë ditë përkujtimore fiktive të kremtuar gjatë viteve të diktaturës mizore të E. Hoxhës si ditë e çlirimit të Shqipërisë, duhet ta braktisin të gjithë shqiptarët përfundimisht e pahezitim. Të gjithë shqiptarët duhet të ndjehen krenarë që fatmirësisht dita e çlirimit të qytetit të Shkodrës nuk përkon me kryefestën e Jugosllavisë së Titos, e cila ka qenë datë ngjarjesh që i kanë sjellë fatkeqësi të panumërta bashkëkombasve tanë përtej kufirit, por më 28 nëntor, në këtë ditë festash mbarëshqiptare, e si të tilla shumë herë të madhërueshme. Më 28 Nëntor 1443 Heroi ynë Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, ngriti në Krujë flamurin e lirisë, që shënoi fillimin e epokës më të ndritur të historisë sonë kombëtare dhe që lartësoi e përjetësoi kudo nëpër botë emrin e kombit shqiptar. Më 28 Nëntor 1912 Ismail Qemali ngriti në Vlorë flamurin e krijimit të shtetit shqiptar, që është një bastion i fuqishëm për ruajtjen e forcimin e unitetit të kombit tonë, që

jeton i copëtuar në disa shtete ballkanike. Edhe 28 Nëntori 1944 qëndron denjësisht me ngjarjet e mësipërme dhe dëshmon për atdheadashurinë e thellë të shqiptarëve dhe gatishmërinë masive të tyre për të luftuar me vetëmohim kundër pushtuesve të huaj sado të fuqishëm që të jenë.

Le të shpresojmë se do të kemi edhe 28 nëntorë të tjerë, që në këtë datë hyjnore emocionesh mbarëkombëtare të kremtohen ngjarjet më madhore të historisë shqiptare.

,